



CONFINDUSTRIA ALBANIA
Associazione degli Industriali Italiani in Albania

KOMUNIKATË PËR SHTYP- REGJISTRI PËR PRONARËT PËRFITUES

Tiranë, 26/02/2021 - Confindustria Albania- Shoqata e Industrialistëve Italianë në Shqipëri ndjek me vëmendje të vecantë çdo iniciativë apo ndryshim legjislativ që i përket sipërmarrjes private në Shqipëri.

Confindustria Albania është në dijeni të Ligjit nr. 112/2020 dhe VKM pasuese n. 1088/2020, me të cilën ligjvënësi shqiptar i është përshtatur me legjislacionit evropian për pastrimin e parave, duke krijuar një regjistër për pronarët përfitues dhe ka ndërmarrë menjëherë masa për të informuar anëtarët e saj, në mënyrë që të gjitha palët e interesuara (midis tyre edhe vetë Confindustria Albania) të jenë në përputhje me kërkesat e këtij ligji brenda afateve të përcaktuara.

Në kushtet e kufizimeve të shumta të vendosura në Shqipëri dhe jashtë saj, për shkak të situatës së krijuar prej Covid- 19, pavarësisht se investitorët e huaj do të përpiqen të përmbushin detyrimet ligjore brenda 60 ditëve (duke filluar nga 2 shkurti 2021) ne nuk përjashtojmë mundësinë e vonesave për shkaqe të ndryshme që s'varen nga biznesi. Për më tepër, periudha e përcaktuar në këtë ligj përkon me një periudhë të ngarkuar për drejtuesit e bizneseve, sepse është sezoni i mbylljes dhe deklarimit të pasqyrave financiare dhe auditimit.

Për sa më sipër, kërkojmë me mirësjellje që Ministria të rishikojë disa nga afatet e përcaktuara me ligj. Më konkretisht, ne do të kërkojmë që:

- Të shtyhet afati i regjistrimit në regjistrin e pronarëve përfitues deri në 30 Qershor, në mënyrë që t'u jepet mundësia të gjithë investitorëve të huaj të përmbushin detyrimet ligjore, pa u ndëshkuar me gjopa të rënda në këtë moment aspak të favorshëm për likuiditetin e sipërmarrjes.
- Të zgjatet vlefshmëria e dokumentave me origjinë të huaj deri në 90 ditë. Teknikisht është e vështirë që një kompani ndërkombëtare të pajiset me dokumentacionin voluminoz në vendin e origjinës, ta apostilojë, ta përkthejë zyrtarisht në gjuhën shqipe dhe ta noterizojë në afatin kohor prej 30 ditësh.
- Janë hasur vështirësi teknike në lidhje me pajisjen me nënshkrim elektronik të shoqërive me administrator shtetas të huaj – si p.sh administratori merr link-un e regjistrimit me email, por nuk arrin të marrë kodin përkatës për aktivizimin e link-ut, i cili dërgohet në

CONFINDUSTRIA ALBANIA
Associazione degli Industriali Italiani in Albania
Sede: Rruga Themistokli Gërmenji, Pallati Frasheri, shkalla 1, ap 12, Tirana, Albania
Tel / Fax. 00355 4 2252687,
info@confindustriaalbania.it
www.confindustriaalbania.it
P.IVA L62412451U



CONFINDUSTRIA ALBANIA
Associazione degli Industriali Italiani in Albania

numrin e telefonit.

- Përveç sa më sipër, shumë nga kompanitë anëtare na konfirmojnë që regjistri nuk funksionon siç duhet. Regjistri elektronik nuk krijon as mundësinë e ruajtjes së aplikimit. Nëse procesi i regjistrimit nuk përfundon me sukses për arsye nga më të ndryshmet, aplikimi rifillon nga pika zero, duke i bërë subjektet të humbin kohë të vlefshme në pritje të ngarkimit të dokumentave.